

**INTERVISTË E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-së,  
AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH, NË “DIPLOMATICUS”, NEWS 24**  
*Transmetuar më 12 prill 2012*

*Intervistoi: Erjona Rusi*

**Mirëserdhët, z. Ambasador dhe faleminderit që pranuat ftesën tonë në “Diplomaticus”.**

Faleminderit juve për ftesën dhe gëzohem që jeni këtu. Mirëmbërëma!

**Mirëmbërëma! Zoti Ambasador, ju keni mbi një vit e gjysmë në Shqipëri. A mund të na thoni diçka të shkurtër rreth kësaj kohe që keni qenë këtu?**

Së pari, më pëlqen të jem këtu. Shqipëria është një vend shumë i bukur, me shumë larmi nga njëra zonë në tjetrën; me malet, detin, luginat dhe njerëzit e mirë që jetojnë aty.

**Besoj keni udhëtuar shumë.**

Po, kam udhëtuar mjaft. Në këto 18 muaj, jam përpjekur ta zbuloj Shqipërinë sa më shumë dhe kam udhëtuar gjithandej. Kam mundur të udhëtoj në një sërë qytetesh të rëndësishme si Korça, Fieri, Shkodra, Kukësi, Saranda, Durrësi, dhe sigurisht nuk do të harroja të përmendja kryeqytetin, Tiranën, dhe shumë pranë Tiranës, Elbasanin. Pra, kam parë një sërë vendesh të rëndësishme, madje edhe vende më të vogla, disa prej tyre në zona tejet të bukura e të ndryshme nga njëra-tjetra si Valbona ose Himara. Në këtë mënyrë, jam përpjekur edhe të mësoj më shumë për Shqipërinë, për të tashmen, për atë çka i nevojitet tani, por edhe për traditat e saj madhështore, të cilat nuk janë të pakta. Për një qytetar gjerman si unë është shumë bukur të zbulojë këtë pjesë të Evropës.

**Ndiheni si në shtëpinë tuaj?**

Paksa, po. Sepse është ajo fryma e përbashkët që kanë evropianët, një frymë që ndiej se po rritet edhe këtu. Disa vite më parë kam punuar në këtë rajon dhe më ka pëlqyer shumë. Pra nuk jam i sapoardhur në Ballkan dhe më pëlqen.

**Jeni disi i lidhur me Ballkanin Perëndimor.**

Është një zonë shumë e bukur. Fatkeqësisht, ekzistojnë disa sfida, të cilat mbeten ende për t'u zgjidhur dhe kjo është, sigurisht, një pjesë e rëndësishme e punës sonë këtu.

**Po. Le të përqendrohemi pak te Shqipëria dhe pastaj do të flasim sërish për Ballkanin Perëndimor. Gjatë kohës që keni qenë këtu, a mendoni se ka pasur më shumë zhvillime pozitive apo negative?**

Një zhvillim tejet pozitiv është se parlamenti tani duket të jetë funksional. Nuk ishte kështu kur mbërrita në vjeshtë të vitit 2010. Gjatë kësaj kohe parlamenti pati mundësinë të marrë vendime shumë të rëndësishme, si për shembull, zgjedhja e Avokatit të Popullit në fund të vitit të kaluar, i cili ishte një hap shumë i mirë. Punë

shumë e mirë po bëhet edhe në drejtime të tjera, si në reformën e sistemit të drejtësisë. Shpresoj, sikurse edhe njerëz të tjerë, të shohim shumë shpejt një vendim për gjykatat administrative. Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është ngritja e komisionit të posaçëm që po trajton çështjen e reformës zgjedhore dhe le të shpresojmë se shumë shpejt do të kemi një zgjidhje.

### **Pra, gjërat kanë ndryshuar paksa për mirë që kur keni mbërritur në Shqipëri?**

Po, do të vlerësoja zhvillimin në parlament si hapin më të rëndësishëm. Sigurisht, ka pasur edhe zhvillime të tjera gjatë kësaj kohe. Një hap shumë i rëndësishëm për shqiptarët ishte liberalizimi i vizave me një numër të konsiderueshëm vendesh, ku Prezenca e OSBE-së ka dhënë ndihmën e saj nëpërmjet krijimit të regjistrimit elektronik të gjendjes civile dhe të sistemit të adresave, elementë vendimtarë këta në liberalizimin e vizave për një sërë vendesh, një punë e cila ende vazhdon. Nga njëra anë, Shqipëria po bën përparim, por nga ana tjetër edhe më shumë përparim duhet bërë akoma.

### **Le të ndalemi pak te një çështje e rëndësishme që ju përmendët, te komisioni i posaçëm për reformën zgjedhore. A jeni i kënaqur me punën që është bërë deri tani në këtë komision?**

Deri tani është bërë punë shumë e mirë. Ende nuk ka përfunduar. Afati i komisionit u shty deri më 30 prill, d.m.th. deri në fund të këtij muaji. Pra, kanë mbetur pak ditë, por nuk janë zgjidhur të gjitha çështjet. Është e rëndësishme të vazhdohet me frymën e bashkëpunimit dhe të dialogut. Kjo nuk do të thotë që çdo anëtar i komisionit të posaçëm apo partitë e tyre të kenë papritur të njëjtin mendim, por do të ishte e rëndësishme që të hartohej një Kod Zgjedhor apo ndryshime në Kodin Zgjedhor, që do të çonin vitin tjetër në zgjedhje parlamentare të mira, të ndershme, të lira e transparente. Jam optimist se ata do t'ia arrijnë kësaj.

### **Meqë po afrohet fundi i afatit, a mendoni se maxhoranca dhe opozita do ta përmbyllin reformën zgjedhore sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe, nëse jo, çfarë do të ndodhë?**

Sikurse ju thashë, jam optimist. Kohë ka dhe ajo çka shoh tjetër është edhe një vullnet i mirë i konsiderueshëm për të arritur këtë zgjidhje. Në jetën parlamentare, mund të jetë nevoja për disa diskutime shtesë, pasi komisioni i posaçëm të ketë paraqitur propozimin për projektligjin e ri të Kodit Zgjedhor. Mund të nevojiten diskutime edhe në komisione të tjera, si për shembull në komisionin e ligjeve, përpara se të merret një vendim, por i takon parlamentit të vendosë se si do të veprojë. Në shumë raste, disa anëtarë të komisionit të ligjeve janë edhe anëtarë të komisionit të posaçëm, pra shoh mundësi të mira për të arritur një Kod të mirë Zgjedhor.

### **Brenda afateve?**

Po, brenda afateve. Sigurisht që nuk flasim për punë gjysmë ore, por përpara pushimeve verore.

**Në një intervistë, tetorin e kaluar nëse nuk gabohem, për një televizion tjetër, keni thënë se duhet të fillojë dialogu mes maxhorancës dhe opozitës. Citoj, “jo hedhje faji, por dialog”. A mendoni se tani ekziston dialog i mirëfilltë, pasi media**

## **dhe qytetarët perceptojnë se loja e hedhjes së fajit vazhdon nga dita në ditë? Ndoshta jo vetëm për reformën zgjedhore, por edhe për çështje të tjera?**

Diskutimi për reformën gjyqësore, përfshirë reformën e gjykatës administrative apo reformën parlamentare kanë nevojë për angazhim. Miratimi i shumë prej këtyre ligjeve thelbësore kërkojnë shumicë të cilësuar, që do të thotë se partitë e mëdha, përfshirë koalicionin e maxhorancës dhe, me shpresë, edhe atë të opozitës, të ulen së bashku dhe të gjejnë gjuhën e përbashkët për të arritur 60 përqindëshin për miratimin e ligjeve dhe për t'i bërë ato të qëndrueshme për një kohë të gjatë në të ardhmen. E them këtë, pasi ajo çka i duhet Shqipërisë është qëndrueshmëria, si për aspiratat e saj të integritetit, ashtu edhe për investuesit, që ata të mund të investojnë për një periudhë më të gjatë e më të sigurt në biznes, që rrjedhimisht çon në hapjen e vendeve të reja të punës. Pra ky dialog, me shpresë, çon në paqe dhe mirëkuptim social, si dhe në zhvillimin ligjor që nevojitet në hapat e integritetit.

### **Po a mendoni se ka një dialog të mirëfilltë tani?**

Po rritet. Disa komente pikante janë me siguri pjesë e çdo jete politike. Çdo vend ka traditat e veta. Është shumë e rëndësishme që pavarësisht atyre që ndodhin në pjesën e zhurmshme, të ekzistojë dialogu, bashkëpunimi konstruktiv dhe vullneti për të arritur kompromise. Lejomëni të shtoj edhe diçka. Duket se fjala “kompromis” nuk kuptohet ende plotësisht. Kompromisi është thelbi i asaj çka kemi në shumicën e vendeve tona dhe është padyshim çka na u desh për integrimin evropian, pasi integrimi ka të bëjë me grupe të mëdha, janë popujt ata që integrohen dhe ata duhet të kenë një mirëkuptim themelor të përbashkët e të gjerë dhe kjo mund të arrihet vetëm përmes kompromisit. Është e pamundur të arrihet kjo kur secili nga grupet, madje edhe grupet e vogla, këmbëngul të marrë gjithçka që dëshiron. Të gjithë duhet të japin e të gjithë sigurisht edhe do të marrin, por kjo balancë e drejtë është e nevojshme dhe e arritshme dhe unë nuk shoh ndonjë arsye që të mos arrihet këtu në Shqipëri. Pra, do të ftoja për një qasje më pozitive ndaj kompromisit, pasi kështu është i gjithë vendi ai që fiton.

### **Më falni, më vjen natyrshëm t'ju pyes për diçka. Kur thoni se kompromisi nuk kuptohet mirë këtu, doni do të thoni se politikanët shqiptarë nuk e kuptojnë mirë punën e kompromisit, jo qytetarët.**

Është shumë e rëndësishme që të mos mendohet se fitimtari duhet të marrë gjithçka. Fitimtari duhet të jetë populli shqiptar, dhe të gjithë shqiptarët shpresoj, pra të mos jetë vetëm një grup ai që fiton gjithçka.

**Le të flasim pak për zgjedhjen e presidentit që është vërtet një çështje e nxehtë aktualisht në Shqipëri. Para pak ditësh ju deklaruat që Kushtetuta e lejon shumicën që të zgjedhë presidentin, por koha e mbetur duhet përdorur në mënyrën e duhur për të gjetur kandidatë të rëndësishëm. Kjo deklaratë e juaja është interpretuar në media dhe nga disa njerëz si devijim nga qëndrimi juaj i mëparshëm, pasi ju keni deklaruar qartë që ju mbështesnit zgjedhjen e një presidenti konsensual. Cili është koment i juaj lidhur me këtë. Ka një lloj devijimi apo jo? Keni ndryshuar pozicionin?**

Është në të njëjtën linjë dhe thekson elementë të ndryshëm. Në të vërtetë, hapi i parë duhet të jetë gjetja e një personaliteti konsensual, duhet parë nëse ka një apo disa

kandidatë që kanë këtë lloj personaliteti. Kjo do të ishte tejet e rëndësishme dhe ëndrra e shumë vetëve, ku futem edhe unë. Nëse, për çfarëdolloj arsyeje, kjo nuk është e mundur, Kushtetuta e Shqipërisë bën të mundur që Shqipëria të vazhdojë të jetë funksionale, pasi ndryshimet e vitit 2008 kërkojnë një shumicë të cilësuar në tri raundet e para dhe nëse nuk gjendet një zgjedhje, megjithëse unë uroj që të ndodhë - dhe prandaj bashkohem me ata që bëjnë thirrje për një kandidat mbipartiak - nëse kjo nuk arrihet, atëherë, në raundin e katërt apo që nga raundi i katërt e më tej mjafton një shumicë e thjeshtë, siç quhet këtu – në vende të tjera quhet shumicë absolute – kjo e mban vendin funksional, duke mos e lënë vakant postin e rëndësishëm të numrit një të shtetit. Pra është e qartë se çfarë thotë Kushtetuta, por duhet të ekzistojë interesimi që të përdoren mirë tri raundet e para, duke shpresuar që koha të shfrytëzohet me sukses.

### **Dhe të përdoret koha e mbetur, pasi nuk ka edhe shumë kohë.**

Në këtë rast ka kohë të mjaftueshme, pasi asgjë nuk ka nevojë për t'u ndryshuar. Procedura e votimit duket se është e qartë, ajo ndodh në parlament, pra nuk është si zgjedhjet e përgjithshme me fushata dhe lista të gjata kandidatësh; ka të bëjë me zgjedhjen e një personaliteti në parlament dhe nga ana tjetër është sigurisht çështje e të genit të drejtë me qytetarët nga njëra anë dhe me deputetët nga ana tjetër që të dilet me kandidatë brenda një kohe të arsyeshme para se të fillojë votimi.

### **Mendoni se kjo temë mund të verë në rrezik dialogun delikat midis dy partive, shumicës dhe opozitës, këtë dialog, këtë bashkëpunim që ekziston tani?**

Nuk mund të jesh krejtësisht i sigurt, por unë jam optimist, disi optimist. Ekziston gjithmonë rreziku që dialogu të ndërpritet, por ai nevojitet për integrimin e mëtejshëm evropian dhe unë kam dëgjuar nga të gjitha palët konfirmimin se integrimi evropian është në interes të vendit e se për të duhet punuar dhe kjo mund të vihej në rrezik nëse në të ardhmen nuk shohim dialog apo nëse dialogu ndërpritet. Dialogu për gjetjen e një kompromisi dhe zgjidhjeve të përbashkëta është i nevojshëm dhe duhet ruajtur.

### **Zoti Ambasador, keni ndonjë koment për deklaratën e Kryeministrit Sali Berisha, që tha se ai nuk pranon këshilla nga përfaqësuesit ndërkombëtarë kur flitet për zgjedhjen e Presidentit pasi kjo është thellësisht çështje shqiptare dhe sidomos që nuk pranon emra individësh?**

Ju e thatë në pyetjen tuaj; është Presidenti shqiptar ai që duhet zgjedhur, kështu që propozimet është e qartë se duhet të vijnë nga populli shqiptar, kryetarët e partive, ose anëtarët e parlamentit, pra nga shqiptarët.

### **Domethënë?**

Nuk kam asgjë për të shtuar.

### **Për këtë koment?**

Po. Është Presidenti i Shqipërisë. Pikë!

**Çfarë mendoni për votimin elektronik; ju e dini se të dyja partitë, shumica dhe opozita kanë pranuar numërimin elektronik të votave, por ishte një ekspert i**

**OSBE-së, nëse nuk gabohe, që dukej skeptik para disa ditësh pasi siç vlerësoi ai, duhet më shumë kohë për të zbatuar këtë lloj teknologjie. Çfarë mendoni për këtë?**

Progresi në komisionin e posaçëm për hartimin e asaj zgjidhjeje është shumë i rëndësishëm dhe numërimi elektronik i votave mund të ndihmojë vërtet, sidomos me elementin që ka të bëjë me përshpejtimin e procesit të numërimit, duke e bërë demokracinë më të gjallë, duke e bërë më të dukshme për qytetarët. Pra është një element shumë i mirë. Ju me të drejtë citoni një ekspert të OSBE/ODIHR-it që ishte këtu gjatë një takimi të grupit të punës që mbajti komisioni i posaçëm i parlamentit me ekspertë nga OSBE/ODIHR e të tjerë. Një prej ekspertëve theksoi një fakt të rëndësishëm, që është ai i besimit të njerëzve dhe besimit të sistemi. Besimi të procesit i votimit është një besim midis njerëzve. Ai nuk mund t'u delegohet makinerive. Pra, ai duhet të ekzistojë në nivel njerëzor dhe vetëm kur ky besim vërtet ekziston në nivel njerëzor mund të mbështetet nga makineritë, duke vazhduar të ekzistojë mes njerëzve. Pra ky është një fakt i rëndësishëm dhe për këtë besim duhet punuar, ai besim duhet ndërtuar; kjo është e para. Gjithashtu, pika e dytë është se kur prezantohen pajisje elektronike kjo duhet bërë përmes një procesi transparent dhe duhet të shoqërohet me trajnim dhe kjo kërkon kohë; blerja e pajisjeve, instalimi i tyre, mbajtja e trajnimeve dhe të shpjeguarit e asaj çka do të ndodhë; pra kjo nuk mund të bëhet në një kohë shumë të shkurtër. Dhe kjo ishte çështja që ngriti eksperti i OSBE/ODIHR-it, pra mund të bëhet.

**Mund të bëhet?**

Mund të bëhet! Pra, është e mundur, por jo në momentin e fundit. Kjo është një arsye tjetër për të cilën vendimmarrja lidhur me reformën zgjedhore duhet bërë shpejt, përndryshe koha deri në zgjedhjet e ardhshme është shumë e shkurtër dhe do të vendoste kufizime sa i takon futjes në mënyrën e duhur të instalimit të numërimit elektronik të votave.

Nga ana tjetër, po diskutohet dhe po mendohet edhe për lexuesit e kartave, aty duket pak më pak e komplikuar, por çdo herë që futen elementë të rinj duhet një kohë për prezantimin e tyre dhe kjo duhet bërë me kujdes dhe në mënyrë transparente që njerëzit, votuesit në këtë rast, të gjithë qytetarët, të mund të besojnë te sistemi. Kjo mund të ndihmojë tej mase për të pasur në fund zgjedhje të lira, të ndershme dhe sigurisht të suksesshme, që çojnë në besim të plotë në demokraci këtu në Shqipëri.

**Pra, nuk ka kohë për gjithë këtë lloj teknologjie, meqë duhet një proces i gjatë, siç e shpjeguat.**

Nuk thashë ashtu. Kohë ka, por varet se çfarë vendoset. Sa më i ndërlikuar të jetë sistemi që prezantohet, aq më shumë kohë duhet. Aktualisht, siç e kuptoj unë deri më tani, kur fokusohem tek numërimi i votave; votuesit do të votojnë, do të shkojnë në qendrën e votimit do të marrin fletën e votimit, do të hedhin votën, dhe më vonë ajo votë, me ndihmë njerëzore, do të numërohet nga pajisjet. Kjo ka verifikim njerëzor nga të dyja anët. Kështu e kuptoj unë deri tani dhe për këtë sistem duket se ka kohë të mjaftueshme. Po të jetë një sistem më i ndërlikuar - pasi ka një sërë sistemesh në tregun botëror - atëherë ndoshta do të duhej më shumë kohë, dhe atëherë koha mbetet e

paktë, pasi nuk ka mbetur më shumë se një vit për të futur një sistem të tillë në afat kohor sa ka mbetur. Koha e mbetur duhet shfrytëzuar mirë.

**Duke qëndruar tek çështja e reformës zgjedhore; një pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi është verifikimi i kartave të identitetit nga komisionet zgjedhore dhe kontrolli i shenjave të gishtërinjve. Cilën alternativë mbështesni më shumë dhe mendoni se duhet që të miratohet nga komisioni i posaçëm.**

Është me rëndësi që anëtarët e komisionit të posaçëm të arrijnë një marrëveshje të përbashkët lidhur me atë që është më e mira për procesin. Ka kuptim që të shtohen hapat e sigurisë në mënyrë që vetëm personat e duhur, pra ata që kanë të drejtë të votojnë, të hedhin votën e tyre.

**Pra, ju nuk është se mbështesni një nga alternativat; ju mendoni që ata duhet të zgjedhin më të mirën.**

Kartat e identitetit janë biometrike dhe të lexueshme elektronikisht. Megjithatë, futja e çdo teknologjie të re ka një çmim dhe pala shqiptare duhet të shohë nëse i ka fondet e duhura në buxhet. Pastaj ka një proces tenderimi, i cili duhet ndjekur edhe për makinerinë e skanimit. Është një proces kompleks, i cili duhet të jetë gjithashtu i operueshëm. Është edhe pjesa ku duhet vendosur nëse do të jetë një sistem *offline* apo *online*. Një sistem *offline* është i mundur dhe, mesa kuptoj, përfshin më pak sfida dhe është më pak i kushtueshëm. Nëse vendoset për një sistem *online* do të duhet më shumë kohë për ta prezantuar dhe më shumë infrastrukturë. Pra, asgjë nuk është e pamundur, por duhet financuar dhe duhet të prezantohet në një mënyrë që të jetë i besueshëm. Kjo varet nga koha dhe fondet e disponueshme, si edhe nga vullneti i mirë për ta bërë të përdorshëm brenda një kohe të shkurtër.

**Kuptoj, pra është një vendim që duhet ta marrë komisioni i posaçëm. Thuajse të gjitha partitë e vogla pretendojmë që PD dhe PS që janë partitë kryesore kanë shkelur barazinë e votës në sistemin aktual zgjedhor proporcional rajonal. Partitë e vogla donin të ndryshonin, ndërsa përdorimi i vetos nga ana e Partisë Demokratike duket se e ka mbyllur këtë çështje. A e keni dhe ju këtë shqetësim si partitë e vogla, lidhur me problemet në sistemin aktual zgjedhor?**

E kuptoj shumë mirë që kërkohet trajtimi i barabartë i votës, sidomos kur vjen puna tek përfaqësimi me vende në parlament. Ka pasur çekuilibra në të shkuarën dhe sigurisht që do të ishte mirë të dilnim me një sistem ku të ketë mesatarisht një numër shumë të ngjashëm votuesish pas çdo deputeti të zgjedhur në parlament. Por kjo është diçka që partitë duhet ta diskutojnë bashkë. Ajo duhet të përfshijë gjithashtu – pasi është një ligj për të cilin duhet vendosur me një shumicë të cilësuar - partitë e mëdha, pra i takon partive ta diskutojnë. Demokracia, kur e krahason me sistemet e tjera në botë, mundëson relativisht një numër shumë të madh zgjedhjesh, të orientuara nga shumica ose tej mase të balancuara dhe sheh shumë shembuj, edhe brenda Evropës, pra është sërish një vendim që i takon palës shqiptare, midis partive, dhe për të cilin në fund merret një vendim në parlament.

**Po, e kuptoj, është vendimi i tyre, por a mendoni që duhet diskutuar më shumë apo është çështje e mbyllur?**

Është e drejtë e palëve të interesuara që ta ngrenë këtë çështje. Unë nuk e shoh si çështje të mbyllur, por rekomandoj që të ecet hap pas hapi, duke mos bllokuar reforma te tjera të rëndësishme që nevojiten për të bërë përpara në rrugën e integritit evropian të Shqipërisë.

**Kuptoj. Ju keni deklaruar që shqiptarët janë ata që duhet ta duan më shumë këtë proces, reformën zgjedhore, ashtu si dhe proceset e tjera të nevojshme për integritin evropian të vendit. Se shqiptarët duhet ta duan më shumë se sa komuniteti ndërkombëtar. Por, për të qenë të sinqertë, a nuk mendoni se në realitet është komuniteti ndërkombëtar që po i shtyn shqiptarët, sidomos politikën shqiptare, në të gjithë këtë proces?**

Më pëlqen kjo pyetje. Shqiptarët sigurisht duhet ta dëshirojnë. Është vendi juaj, Erjona dhe, kur flas me qytetarët, kam ndjesinë që ata e duan një gjë të tillë. Është e vështirë të kuptohet se ç'do të thotë integritim në të vërtetë, por kjo ka të bëjë gjithashtu me zhvillime mjaft të rëndësishme, për një pjesë të të cilave sapo folëm. Kjo ka të bëjë me miratimin e ligjeve të rëndësishme, por gjithashtu edhe me zbatimin e plotë të tyre. Sigurisht, që është një fushë e hapur pune, ku çdo qytetar mund të marrë pjesë, jo vetëm si votues, por edhe duke qenë aktiv, duke treguar angazhim në shoqërinë civile dhe duke marrë pjesë deri diku në jetën publike, në rritjen e komunikimit, në gjetjen e zgjidhjeve të mira, për ta bërë jetën akoma më të frytshme.

**Janë gjithë këto gjëra që ju thoni se shqiptarët duhet të bëjnë. Duket sikur ne nuk i bëjmë këto gjëra, sikur nuk na intereson shumë, apo ndoshta integriti evropian, apo politika, nuk është pjesë e jetës sonë. Ndaj ju pyeta. Duket sikur komuniteti ndërkombëtar gjithmonë na shtyn të bëjmë gjëra. Përsërisin gjithmonë mesazhe për gjërat që duhet të bëjmë. Si një prind.**

Kjo është e vërtetë. Por në rastin e Prezencës së OSBE-së, ka gjasa që ne kemi mandatin më të veçantë sepse ne jemi këtu me mandat, me ftesë të qeverisë shqiptare për të ndihmuar në forcimin e institucioneve dhe gjithashtu për të ndihmuar ndërtimin e shoqërisë civile. Kjo është në mandatin e ndryshuar në vitin 2003. Ne, si Prezencë OSBE-je, jemi ftuar për të bërë një gjë të tillë, dhe jemi të lumtur ta bëjmë duke dhënë këshilla, por jo për ta bërë vetë, duke punuar me homologët shqiptar, autoritetet dhe shoqërinë civile, duke ndihmuar me trajnime dhe duke treguar se çfarë mund të bëhet, cilat mund të jenë hapat e mëtejshme për të ecur përpara. Kjo që ofron OSBE-ja është një gjë shumë e veçantë dhe Prezenca është e mandatuara për ta bërë. Kjo vërtet na bën të lumtur. Së fundmi ne shënuam 15-vjetorin e punës këtu. Të shohësh ndryshimin drastik dhe progresin dramatik këtu në vend nga viti 1997 deri më sot është shumë e kënaqshme, por nuk është fundi i rrugës së gjatë. Kur vështron jashtë sheh sa ka akoma shumë për t'u bërë. Nëse mund të shpreh një dëshirë personale, unë do të doja të shihja edhe më shumë progres në fusha si arsimit. Edhe aty është bërë shumë, por çështja e arsimit është jashtëzakonisht e rëndësishme, ngaqë përfaqëson një investim të vërtetë te për njerëzit, pra tek e ardhmja.

**Pra, do të na duhet më shumë ndihma juaj në të ardhmen. Le të flasim pak për një temë tjetër e cila përfaqëson një çështje të rëndësishme dhe që ka shkaktuar shpesh polemika dhe debate te forta ndërmjet maxhorancës dhe opozitës, ngjarjet e 21 Janarit. Ekspertë të Këshillit të Evropës ishin në Tiranë dhe sapo përfunduan një vizitë zyrtare në vendin tonë. Ata kërkuan që hetimet për**

**ngjarjet e 21 Janarit të përfundohen. Gjithashtu, ata kërkuan që institucioneve t'u jepet pavarësia dhe liria e nevojshme për të arritur përfundimet e duhura. Cili është mendimi i juaj për këtë?**

Mendoj pak a shumë njësoj. Duhet të jetë transparent, i vërtetë, dhe të bëhet maksimumi për gjetjen korrekte të fakteve. Me sa duket, nuk është e thjeshtë dhe kërkon mjaft kohë. Së bashku me të tjerë do të kisha dëshiruar që të kishte analiza edhe më të shpejta, por transparenca dhe vërtetësia janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Prandaj, në këtë kuadër ndaj ekzaktësisht të njëjtin qëndrim me Këshillin e Evropës.

**Faleminderit. Zoti Ambasador, OSBE-ja ndihmon Shqipërinë gjithashtu për projekte në lidhje me qeverisjen e mirë, pjesë shumë e rëndësishme e së cilës është lufta ndaj korrupsionit. Fatkeqësisht, na duhet të themi se niveli i korrupsionit në Shqipëri është ende shumë i lartë dhe shqetësues, sipas raporteve ndërkombëtare, dhe duket se Shqiptarët besojnë gjithnjë e më pak te shteti i së drejtës. Sipas mendimit tuaj si Kryetar i Prezencës së OSBE-së, cili është problemi, është shoqëria, politika?**

Një element mund të jetë që njerëzit ende mendojnë se është pjesë e kulturës. Unë do ta kundërshtoja këtë. Si pjesë e mënyrës me të cilën ne mundohemi të punojmë, unë ftoj të ketë më shumë angazhim civil dhe, kur duket se ka shfaqje korrupsioni, këto të denoncohen tek autoritetet. Tani që zyra e Avokatit të Popullit është plotësisht funksionale, ekzistojnë shumë mundësi dhe mënyra për të denoncuar korrupsionin dhe për mos ta bërë atë, pra për mos të paguar atë tarifë shtesë. Kur është për t'u denoncuar keqfunksionimi i autoriteteve, duhet përdorur ky institucion shumë i rëndësishëm i sistemit shqiptar që është përsëri plotësisht funksional. Është shumë interesante dhe tregon një histori gjithashtu shumë të rëndësishme rreth konceptit të Kushtetutës, fakti që, në Kushtetutë, Avokati i Popullit dhe zyra e Avokatit të Popullit përshkruhet përpara institucionit të Presidentit madje. Ky është një mjet shume i fuqishëm për njerëzit në mënyrë që ata të marrin të drejtat e tyre dhe është e qartë që korrupsioni përbën diçka që duhet eliminuar. Duke ju kthyer elementit të kulturës, korrupsioni ndodh dhe në shoqëri të tjera. Pra, nuk është diçka e veçantë që ekziston vetëm në Shqipëri, por shoqëri të tjera, me anë të angazhimit civil, kanë mundur të arrijnë një nivel më të ulët korrupsioni. Kuptohet që niveli ideal i korrupsionit do të ishte zero, por duhet synuar niveli afër zeros. Kjo ka nevojë për ndihmën e qytetarëve.

**Duket pak e pamundur.**

Kërkon shumë punë, por nuk është e pamundur. Shtete të tjera ia kanë dalë mbanë dhe jam i sigurt se Shqipëria mund të bëjë të njëjtën gjë. Një nga gjërat që vërtet admiroj këtu është se njerëzit mësojnë shumë shpejt dhe mund t'ia dalin mbanë. Shqiptarët mund t'ia dalin mbanë.

**Por për të denoncuar një rast ryshfeti për shembull, nevojitet besim tek institucionet.**

Saktë.



**Unë mendoj se ky është problemi. Nuk ka besim tek institucionet. Unë mund të denoncoj një rast ryshfeti apo një person që kërkon para prej meje, por nevojitet që unë të kem besim tek institucionet. Ky është problemi kryesor.**

Jam plotësisht dakord. Kjo që po thoni përbën një element shumë të rëndësishëm. Pikërisht për këtë arsye unë përmenda zyrën e Avokatit të Popullit. Unë ju ftoj të keni besim tek ajo zyrë.

**Ju e dini që Shqipërisë i është refuzuar dy herë statusi kandidat për në BE. E di që ju keni thënë në intervista të tjera që pyetja nëse Shqipëria do ta marrë statusin kandidat këtë vjeshtë është një pyetje që më shumë u duhet drejtuar përfaqësuesve të BE-së. Por a nuk mendoni se sukcesi apo dështimi i reformës zgjedhore që është një nga prioritetet kuçe të kërkuara nga Komisioni Evropian, si dhe i reformave të tjera, do të jetë vendimtar për marrjen apo jo të statusit të vendit kandidat?**

Unë si vëzhgues, në rolin tim aktual si ambasador i OSBE-së, por duke qenë se unë jam gjithashtu një diplomat gjerman dhe kam punuar në të shkuarën rreth çështjeve evropiane, do të këshilloja të dëgjohet me shumë vëmendje se çfarë thotë BE-ja. Komisioni bën rekomandimin dhe shtetet anëtare vendosin. Por BE-ja, si një e tërë, gjithmonë ka treguar drejt një pike shumë të rëndësishme: shteti. Unë përshkrova më parë se çfarë është shteti. Kjo vendos shpejtësinë e integritit. Bashkimi me një komunitet, disa e quajnë si bashkimin në një klub, ka të bëjë më atë që kur bashkohesh me diçka duhet të respektohet rregullat. Vlerat dhe angazhimet që Shqipëria ka pranuar me OSBE-në, në shumë pika ngjajnë me ato të BE-së. Çdo shtet vendos se sa shpejt do të përmbushë hapat e nevojshëm për t'u bashkuar me një subjekt të caktuar.

**Por a mendoni se sukcesi apo dështimi do të jetë vendimtar për të marrë statusin e vendit kandidat këtë vjeshtë?**

Do të ishte spekulim, por ne kemi parë progres shumë të madh. Më i rëndësishmi është që Parlamenti duket se është përsëri plotësisht funksional dhe kjo është shumë e rëndësishme për vendin.

**Pyetja e fundit ka të bëjë me eksperiencën tuaj mbi zhvillimet në Ballkanin perëndimor dhe në politikën ndërkombëtare. Kërkoj një mendim nga ana e juaj rreth Ballkanit Perëndimor si rajon ose me te gjitha shtetet përbërëse. Do bëj një përmbledhje të shkurtër nga ana ime: Kosova është ende duke u përballur me dhunën në veri. Maqedonia vazhdon të mos ketë zgjidhur çështjen e emrit me Greqinë dhe së fundi është përballur me tensione etnike, të cilat kanë treguar përsëri bashkëjetesën e brishte midis shqiptarëve dhe maqedonasve atje. Dhe pas njëzet vjetësh, Bosnja vazhdon të jetë e ndarë etnikisht. Ndërsa përsëri pas njëzet vitesh Shqipëria vazhdon të përpiqet të konsolidojë demokracinë e saj të brishtë. Duke parë këtë tablo jo të këndshme, pyetja ime është a ka dështuar komuniteti ndërkombëtar në Ballkan?**

Unë do të dëshiroja të kishte progres akoma më të shpejtë, por mund të them që në rajon ka pasur progres të jashtëzakonshëm. Më lejoni të them, dhe nuk e kam me shaka, Greqia është pjesë e Ballkanit Perëndimor dhe ka dekada që është anëtare e Bashkimit Evropian, Sllovenia është bërë anëtare, Kroacia do të bëhet anëtare vitin e

ardhshëm, pra hapa të rëndësishëm po ndërmerren. Të gjitha shtetet e tjera synojnë integrim të mëtejshëm evropian dhe të ecin përpara. Disa nga to shumë ngadalë. Është një rrugë e gjatë. Pikënisjet gjithashtu ishin, gjithashtu, shumë të ndryshme dhe e shkuara e veçantë e Shqipërisë e ka bërë veçanërisht të ndërlikuar për të kapur ritmin e të tjerëve dhe ky proces është ende duke ndodhur me shpejtësi të jashtëzakonshme. Për mua dhe ekipin tim është shumë e kënaqshme të punosh këtu dhe të përpiqesh fort për të ndihmuar dhe për të dhënë kontribut në këtë zhvillim. Unë shoh më shumë se dritë në fund të tunelit. Demokracia këtu nuk është aq e brishtë sa mund të mendohet. Njerëzit janë të interesuar. Ata shohin lajmet në televizor dhe lexojnë gazetat. Një numër gjithnjë në rritje njerëzish po angazhohet me shoqërinë civile. Pra diskutimi ka filluar dhe ata duan të kenë këtu një jetë shumë të ngjashme me jetën në pjesë të tjera të Evropës. Në këtë aspekt, kam shumë besim. Por është një proces zhvillimi dhe duke marrë parasysh pikënisjen e largët, rruga e bërë është e jashtëzakonshme, por ky nuk është fundi. Ajo për të cilën ka nevojë demokracia, dhe kjo vlen dhe për demokraci të forta të ashtuquajtura demokraci të vjetra apo tradicionale, është që ajo të mbrohet përditë, të mos trajtohet si diçka të vetëkuptuar, por si diçka që ka nevojë të mbrohet nga fryma e të gjithë qytetarëve, të cilët duhet ta duan dhe të respektojnë rregullat. Gjërat si korrupsioni, trafikimi apo krimet nuk janë pjesë e saj. Ajo ka nevojë të mbrohet dhe votimi është një pjesë shumë e rëndësishme. Por nuk mjafton vetëm votimi çdo dy vjet, nëse numërohet votimi për zgjedhjet vendore, por nevojitet dhe pjesëmarrja në jetën publike me angazhime civile. Shoh që është bërë shumë progres në Shqipëri, por ka akoma për të bërë. Siç ju thashë, jam optimist se mund t'i dilet mbanë. Shqipëria mund t'ia dalë mbanë.

**Po për Kosovën, Maqedoninë dhe Bosnjën, a shikoni përsëri një tablo më pozitive krahasuar me atë tablonë e shëmtuar që bëra më parë?**

Po. Por meqë po punoj këtu në Shqipëri dhe ne kemi gjithashtu misione të OSBE-së në shtetet kufitare, u takon më shumë atyre për të komentuar situatat, duke qenë se ata janë aty. Por meqë përmendët fjalën rajon përsëri, një element duhet të jetë shumë i qartë, dhe këtë mund ta them nga çdo pikë e planetit: kufijtë ndërkombëtarë do të qëndrojnë siç janë.

**Fund**